



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 16 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve si dhe me aktin nr. 2129 prot., datë 12.04.2024, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kompetenca mbi organizimin dhe funksionimin e shërbimeve, të cilat lidhen me administrimin gjyqësor, brenda parashikimeve ligjore të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 91, të këtij ligji, me qëllim përmbushjen e funksionit të tij për të siguruar mbarëvajtjen e marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun, Këshilli, me vendimin nr. 716, datë 06.12.2023 ka miratuar “Udhëzuesin standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”, akt në të cilin përcaktohen rregullat dhe procedurat e informimit dhe komunikimit të gjykatave me publikun dhe median.

Në nenin 12, pika 2 të Udhëzuesit të mësipërm parashikohet se “*Si rregull, personave të interesuar për përdorimin e vendimeve gjyqësore për qëllime studimore, shkencore, statistikore, literature apo gazetarie, i vihet në dispozicion vetëm kopja e vendimit të plotë, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi*”. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se, referuar nenit 46 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhënia e informacioneve mbi çështjet dhe vendimet gjyqësore është kompetencë e gjykatave respektive nëpërmjet shërbimit të marrëdhënieve me publikun që funksionon pranë çdo gjykate.

Për sa u përket më sipër, si dhe në kushtet kur në kërkesën tuaj nuk janë specifikuar gjykatat kompetente që kanë dhënë vendimet gjyqësore përkatëse, lutemi të drejtoheni me një kërkesë pranë tyre me qëllim marrjen e informacionit të kërkuar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!